



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001319/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandim për marrjen e masave, për garantimin e të drejtës për arsim të fëmijës me incialet N.SH., me aftësi të kufizuara, në interesin më të lartë të tij

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

BASHKISË BERAT

DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE

BERAT

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës, si dhe të ligjit të tij organik të organizimit dhe funksionimit, mori në shqyrtim ankesën e shtetases Pranvera Shano. Kjo ankesë adreson problematikën e privimit të fëmijës me incialet N.Sh., 9 vjeç, me aftësi të kufizuara, për t'u integruar në shoqëri.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të

çështjes, duke kërkuar informacion nëpërmjet komunikimit zyrtar¹ me Bashkinë Berat, për ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara ditore, për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Nga analizimi i informacionit të dërguar nga Bashkia Berat², konstatojmë se fëmija me inicialet N.Sh., 9 vjeç ka marrë shërbime sociale të specializuara³ pranë qendrës “Lira” Berat, por nuk është regjistruar në institucionet e arsimit parauniversitar, duke shfaqur kështu problematikë në drejtim të garantimit të së drejtës së fëmijës për t’u arsimuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e mirë të kryer nga qendra “Lira”, për ofrimin e shërbimeve sociale ditore për fëmijën me inicialet N.Sh., por shpreh shqetësimin e tij institucional, për sa i përket ndërprerjes së shërbimeve në funksion të rehabilitimit të fëmijës dhe integritit në shoqëri⁴.

Në këtë kuptim, vazhdimësia e punës në ofrimin e shërbimeve integrale, kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale, për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën me institucionet e tjera jashtë qendrës (p.sh. me Zyrën Vendore Arsimore të qytetit, prindërit, etj.), në zbatim të legjislacionit të ri të shërbimeve sociale⁵, bazuar në plotësimin e nevojave apo minimizimin e ndikimit të pasojave negative të dukurive sociale të fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ky bashkëpunim dhe bashkërendim është i rëndësishëm, lidhur me garantimin e vazhdimësisë së punës, për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale, për identifikimin, vlerësimin, përfshirjen dhe integrimin e kësaj kategorie në jetën shoqërore, në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Sikundër, sërish me keqardhje konstatohet, se shpesh herë rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit⁶ nuk zbatohen korrekt në praktikë. Konkretisht, ato që institucioni ynë ka rekomanduar në vijëmbësi, për marrjen e masave në mënyrë të vazhdueshme, për konsolidimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me strukturat e tjera, të cilat ofrojnë shërbime publike, për të mundur integrimin e përfituesve me diagnoza të lehta të shëndetit mendor në shkolla normale dhe kurse profesionale, me qëllim punësimin e tyre, për të realizuar jetesë të pavaruar, duke krijuar raporte të vazhdueshme

¹ Shkresat zyrtare nr.dok.201901319/2, datë 18.11.2019 dhe nr.201901319/12, datë 31.12.2020, të institucionit të Avokatit të Popullit.

² Shkresat zyrtare nr.237, prot. datë 2.12.2019 dhe nr.650/1 prot., datë 13.2.2020, të Bashkisë Berat.

³ Në këtë rast shërbimet sociale të specializuara, të ofruara për fëmijën kanë qenë të tipit: logopedi, dy vakte ushqimore, socializim, etj.

⁴ Shërbimet për fëmijën me inicialet N.Sh., janë ofruar nga muaji tetor 2016 deri në muajin qershor 2018.

⁵ Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

⁶ Rekomandimet për garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Qendrën “Lira”, Berat, shkresa zyrtare nr. dok.201900095/2, datë 29.5.2019, të institucionit të AP.

dhe të herëpashershme me shkollat, bizneset, profesionistët e lirë, etj., nuk vlerësohen drejt, e për rrjedhojë, problematikat vazhdojnë të mbeten prezent.

Dhe në të njëjtën qasje, institucioni ynë ka adresuar rekomandimin⁷ për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave, për hartimin e udhëzimit të përbashkët, ndërmjet këtyre ministrive në zbatim të pikave 1 dhe 6, të nenit 64, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar⁸.

Duke u kthyer në rastin në fjalë, sjellim në vëmendje, se e drejta e çdo fëmije për t’u arsimuar, siç e parasheh neni 18, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, është një e drejtë themelore, e pandarë dhe e patjetërsueshme.

Në këtë kuptim, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit tek fëmijët me aftësi të kufizuara dhe, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve, Avokati i Popullit,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga autoritetet përgjegjëse për çështjet e arsimit, për regjistrimin e fëmijës me inicialet N.Sh., në një institucion arsimor pranë vendbanimit të familjes.
- Marrjen e masave nga Komisioni Multidisiplinar pranë Zyrës Vendore Arsimore Berat, për vlerësimin e nevojave të fëmijës me inicialet vënie N.Sh. dhe hartimin e Planit Edukativ të Individualizuar të objektivave specifike të nivelit të zhvillimit të fëmijës.

⁷ Rekomandime lidhur me inspektimet e realizuara pranë Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë “Ramaza Kabashi”, Tiranë, shkresa zyrtare nr.dok.201701634/2, datë 26.1.2018, e institucionit të AP-së.

⁸ Pika 1 e nenit 64, të ligjit nr.69/2012, përcakton shprehimisht detyrimin që ka MASR, që : “...Nxënësve me aftësi të kufizuara t’u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kritereve të miratuara nga ministri dhe Ministri i Shëndetësisë...”. Ndërkohë, që pika 6 e po këtij neni, përcakton detyrimin që ka njëzia arsimore vendore, që: “... sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit për gjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, i siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundën të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë...”.

- Marrjen e masave nga Zyra Vendore Arsimore Berat, për vënien në dispozicion të një mësuesi ndihmës në shkollën ku do të regjistrohet fëmija, për të mbështetur dhe asistuar nxënësin me inicialet N.Sh.
- Marrjen e masave nga Bashkia Berat, për të zbatuar korrekt në praktikë rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit në shkresën zyrtare nr.dok.201900095/2, datë 29.5.2019.
- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për hartimin e udhëzimit të përbashkët ndërmjet këtyre ministrive, në zbatim të pikave 1 dhe 6, të nenit 64, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditë nga data e dërgimit.

Për, sa më sipër, lutemi në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi. Ky rekomandim është pjesë e raportimit periodik të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit nr.49/2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe do të vlerësohet edhe nga grupi i ngritur për këtë qëllim nga Kryetari i Kuvendit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA